



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Bazuar mbi:	19.03.25	
Emri:		
Adresa:	Shtet:	Shtet:
Adresa:	Shtet:	Shtet:

05-453/01-12425



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret,standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Drejtoriati për Kulturë,Rini dhe Sport bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që selin dhe adresën e OJQ-së e kanë në teritorin e Komunës së Lipjanit që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin **FESTIVALI I KËNGËS PËR FËMIJË "LIPJANI KËNDON"** ,E që kontribuojnë në Kulturë dhe Rini në Komunën e Lipjanit.

Organizatrat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt përmes aktiviteteve si më poshtë:

Objektivat:

- Promovimi I talentëve të rinjë në muzikë
- Realizimi I garave mes Fëmijëve

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 5.000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo project është 501.00euro, ndërsa shuma maksimale për një project është 5.000.00 euro.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me 10.04.2025.

Periodha e zbatimit të projektit është deri 1 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare me seli dhe adresë në teritorin e Kosovës.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës,OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën (mergim.oruci@rks-gov.net)

Lipjan, më 19.03.2025

Anila Reçica Llugiçi
Drejtoreshë e DKRS-së

